



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SKRAPAR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

NR. 36 , Datë 18.07.2019

**MBI DHËNIEN E PAGESAVE PËR AFTËSINË E KUFIZUAR PËR MUAJIN
KORRIK 2019**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"si dhe në nenin 7 dhe nenin 29 pika 2 të ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar; VKM nr.618 datë 07.09.2006 "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të masës së pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar; Udhëzim nr. 366, datë 21.9.2017 "Mbi zbatimin e vendimit nr. 618, date 07.09.2006, të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", ligjin nr. 8089 , date 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit" i ndryshuar, VKM nr. 277 datë 18.06.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit" Udhëzimin nr. 367 , datë 21.09.2017 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr .277 ,të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga Statusi i të Verbërit", i ndryshuar , Ligjin nr. 8626 , datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" , VKM nr. 31 , datë 20.01.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar; Udhëzimin nr. 365 datë 21.09.2017 "Mbi zbatimin e Vendimit Nr.31 , datë 20.01.2001 , të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i invalidit , paraplegjik dhe tetraplegjik" i ndryshuar , VKM nr. 869, datë 18.06.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 "Statusi i invalidit".

Këshilli Bashkiak pasi mori në shqyrtim materjalin e prëgatitur nga Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Paaftësisë

V E N D O S I :

1.Pëfitojnë pagesë paaftësie për muajin Korrik 2019 në total 526 persona me 6 217 155 lekë , të ndarë në:

- Të paaftë 260 persona me fond 2 529 600 lekë në muaj
- Kujdestarë paaftësie 80 persona me nje fond 816 850 lekë në muaj
- Të verbër 113 persona me një fond 1 417 836 lekë në muaj
- Kujdestarë të verbër 25 persona me një fond 299 125 lekë në muaj.
- Para e tetraplegjike 24 persona me një fond 636 960 lek në muaj.
- Kujdestarë para e tetraplegjikë 24 persona me një fond 265 680 lekë në muaj.

- Kompesim për energjinë elektrike 117 persona me fond 241 104 lekë në muaj.
- Kompesim për telefon 10 persona me nje fond 10 000 lekë në muaj.

2. Përfitojne pagesë per shkak Invaliditeti në punë për muajin Korrik 2019 në total 340 persona me fond 1 023 200 lekë.

Vendimi u miratua me: 9 vota pro , - vota kundër , - vota abstenim .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



**KRYETARI KËSHILLIT
PARTIZAN GORÇE**